



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
MINISTRI



Nr. 211201 Prot

Tirane, më 15-11 2011

URDHËR

Nr. 80 Datë 15-11 2011

“PËR MIRATIMIN E RITJES SE KAPITALIT TE SHOQERISE “NXITJA E
BIZNESIT SOCIAL” SH.A

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2 gërma “ë” dhe pikës 4 të nenit 135, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të Ligjit nr. 10376, dt. 10.02.2011, “Per krijimin e shoqerise “Nxitja e Biznesit Social”. sh.a, nenit 8 të VKM nr.391, dt.01.06.2011, “Per miratimin e Statutit të shoqerise “Nxitja e Biznesit Social”, sha”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.1, dt.21.09.2011, të Keshillit të Administrimit të shoqerise Nxitja e Biznesit Social sh.a “Mbi rritjen e kapitalit të shoqerise”, : Ministri i Financave në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë aksionare “Nxitja e Biznesit Social sh.a”

URDHËRON:

1. Te behet rritja e kapitalit të shoqerise “Nxitja e Biznesit Social” sh.a në vlerën 150 000 000 (njqind e pesedhjetë milione) leke brenda vitit 2011.
2. Ngarkohet shoqeria “Nxitja e Biznesit Social” sh.a për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLICA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 1489, datë 15.10.2011

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.391,
DATË 1.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E STATUTIT TË SHOQËRISË "NXITJA E BIZNESIT SOCIAL", SH.A."**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 8, të ligjit nr.10 376, datë 10.2.2011, "Për krijimin e shoqërisë "Nxitja e biznesit social", sh.a.", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në statutin e shoqërisë "Nxitja e biznesit social", sh.a., që i bashkëlidhet vendimit nr.391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në nenin 5, "Kapitali", bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 formulohet, si më poshtë vijon:

"2. Në çastin e themelimit, shteti shqiptar, i përfaqësuar nga ministri i Financave, kontribuon në para, në kapitalin e shoqërisë, me një shumë prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, e cila përfaqëson kapitalin fillestar të shoqërisë. Kjo shumë do të përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për vitin 2011."


b) Në pikën 3, fjalët "... Ministria e Financave ..." zëvendësohen me "... ministri i Financave ...".

Pas pikës 2, të nenit 8, "Rritja e kapitalit", shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Kontributi i shtetit shqiptar për rritjen e kapitalit të shoqërisë do të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I



SALI BERISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 2908/1 Prot

Tirane, më 15.3 2012

URDHËR

Nr 14 Datë 15.3 2012

**"PËR MIRATIMIN E RRIJTJES SË KAPITALIT TË SHOQËRISË "NXITJA E
BIZNESIT SOCIAL" SH.A**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2 gërma "ë" dhe pikës 4 të nenit 135, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të Ligjit nr. 10376, dt. 10.02.2011, "Për krijimin e shoqërisë "Nxitja e Biznesit Social", sh.a. nenit 8 të VKM nr.391, dt.01.06.2011, "Për miratimin e Statutit të shoqërisë "Nxitja e Biznesit Social", sha", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.3, datë.21.09.2011, të Këshillit të Administrimit të shoqërisë Nxitja e Biznesit Social sh.a "Mbi rritjen e kapitalit të shoqërisë", Ministri i Financave në cilësinë e akcionerit të vetëm të shoqërisë aksionare "Nxitja e Biznesit Social sh.a"

URDHËRON:

1. Të bëhet rritja e kapitalit të shoqërisë "Nxitja e Biznesit Social" sh.a në vlerën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë brenda vitit 2012.
2. Ngarkohet Shoqëria "Nxitja e Biznesit Social" sh.a për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

RIDVAN

